



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna e Dragashit – Opština Dragaš – Municipality of Dragash

Kryetari i Komunës

02 Nr. 400-9259

Di: 08. 06. 2016

Dragash

Në bazë të kërkesës së parashtruar nga z.Flamur Sylejmani – Zyrtar i lartë për Bujqësi, Turizëm e Zhvillim Rural në Komunën e Dragashit i autorizuar nga kryetari i Komunës me dt.12.05.2016 që në emër të Komunës të bëjë pranimin e kuajve si donacion nga APK-ja, për nevojat e qytetareve të komunës sonë, kërkon nga Komuna gjegjësisht nga kryetari i Komunës që z.Nesim Hasani nga fsh Kuk, të bëhet pagesa për shërbiet e kryera gjegjësisht për transportin e kuajve të dhuruar si donacion nga APK-ja, e bazuar në nenin 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dhe nenin 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

- I. **TË LEJOHEN** mjetet në shumë prej **230,00 Euro** për z.Nesim Hasani nga fsh Kuk, në emër të pagesës për transportin e kuajve të dhuruar si donacion nga Agjencia Pyjore e Kosovës për nevojat e fermerëve të Komunës sonë, në xhiro-llogarinë nr.**1301003009931766 – BPB**.
- II. Për implementimin e këtij Vendimi **OBLIGOHET** Drejtoria për Financa, Ekonomi e Zhvillim e Komunës.
- III. Mjetet të lejohen nga pozicioni buxhetor për mallra e shërbime të Komunës.
- IV. Për veprimet e më tejme të njoftohet kryetari i Komunës.

Shtojcë: kërkesat, procesverbalet, autorizimi, vendimi, kopja e letërnjoftimiti dhe e xhiro-llog.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Financa, Ekonomi e Zhvillim të Komunës.
- Drejtorisë për Bujqësi të Komunës.
- z. Nesim Hasani, dhe
- Arkivit



Kryetari i Komunës

[Signature]



Komuna Dragash
Opstina Dragas
Municipality Dragas



KLUB I MUNDJES -
VRESTLING CLUB
PRIZRENI
Address: Rr. Qazim Berisha
p.n. Prizren - Kosovë,
Tel; 044948888/Fax.+381 38
631475

Duke e bazuar ne Planin zhvillimor lokal 2013-2023 të Komunës se Dragashit (Zhvillimi i Turizmit dhe promovimi i trashigimisë kulturore), duke u bazuar në nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në statutin e Komunës se Dragashit në nenin 57, kryetari komunës lidhë:

MARRVESHJE PËR BASHKFINANCIM

Nr: 400-9773
Dt: 08.06.2016

1. Në mes të :

- Komunës së Dragashit , përfaqësuar nga z.Salim Jenuzi- Kryetar i Komunës dhe
- Klubi i Mundjes "PRIZRENI" nga Prizreni, përfaqësuar nga z.Sylejman Shala- Kryetar i Klubit..

2. Palët e lartshënuara pajtohen me sa vijon:

Implementimin e projektit **Organizimi i garave te Pehlivanëve dhe Vrapimi i kuajve** me bashkëfinancim te përbashkët në mes të Komunës se Dragashit dhe Federata e Mundjes si dhe Klubi i Mundjes "Prizreni nga Prizreni, me seli ne Prizren, ku qëllimi i keti projekti është **Ruajtja dhe Promovimi i Trashëgimisë kulturore**. Ky projekt ka impakt regional dhe i cili do te kontribuoj drejtpërdrejt ne ngritje te zhvillimit të turizmit të Komunës se Dragashit dhe të Regjionit te Sharrit.

Vlera e përgjithshme e projektit është **13000 euro** (trembëdhjetë mijë euro).

3. Komuna e Dragashit do ta mbështes financiarisht projektin **8000 Euro (65 % të vlerës se përgjithshme të projektit)**. Komuna e Dragashit ne zbatimin dhe implementimin e keti projekti do të mbështes me logjistikë dhe me personel deri ne implemtim përfundimtar.
4. Klubi i Mundjes "PRIZRENI" nga Prizreni do të kontribuojnë në bashkëfinancimin e projektit në vlerë prej 35 % te vlerës se përgjithshme (5000 euro), me mjete te përkrahura nga Federata e Mundjes Prishtinë. Klubi i Mundjes "PRIZRENI" do te beje organizimin e dy aktiviteteve :



Komuna Dragash
Opstina Dragas
Municipality Dragas



KLUB I MUNDJES -
WRESTLING CLUB
PRIZRENI
Address: Rr. Qazim Berisha
p.n. Prizren - Kosovë,
Tel ,044948888/Fax,+381 38
63 1475

1. Garat e Pehlivanëve (do te ftohen pehlivan te kategorive te ndryshme nga shtetet : Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Bullgaria etj).
2. Vrapimin e kuajve (do te marrin pjes garues te ndryshëm nga shtetet : Kosova, Shqipëria, Maqedonia etj).

5. *Transferi i mjeteve*

Mjetet financiare te aprovuara nga **Komuna e Dragashit** për këtë projekt do të transferohen ne xhirollogarinë e **Klubit të Mundjes "PRIZRENI"** me seli në Prizren, me numër te regjistrimit: **5114154-7**, numer fiskal **600961264** me numër te xhirollogarisë **1502031001929710** banka: Raiffesien Bank ,

6. *Monitorimi*

Monitorimi i projektit do te behet nga komisioni i autorizuar komunal ne dy aktivitetet gjate implementimit

7. *Raportimi*

Klubi i Mundjes "PRIZRENI" nga Prizreni si bartëse e projektit, pas zbatimit te projektit, do te bej një raport detal mbi shpenzimet e bëra dhe do të raportoj te Komuna e Dragashit .

Kryetari Komunes se Dragashit
Saim Jenuzi



Kryetari i Klubit te Mundjes Prizreni
Sylejman Shala





Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality

- Kryetari i Komunës

02 Nr. 400-9879

Dt. 10. 06. 2016

D r a g a s h

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

- I. **THEMELOHET** Komisioni (Organi) për Pranimin Teknik të punimeve në hartimin e projektit: “Zgjerimi i rrugës Dragash – Brod”, në përbërje:
 1. z.Amdija Šeapi,
 2. z.Sabahat Hasani dhe
 3. z.Mensur Halili
- II. Për implementimin e këtij Vendimi obligohet Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastër e Mbrojtje të Mjedisit të Komunës.
- III. Detyrë e anëtarëve të Komisionit është hartimi i Raportit lidhur me këtë dhe njoftimi i organeve të lartcekura.
- IV. Për hapat e ndërmarr të njoftohet kryetari i Komunës.

I dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit....
- Zyrës së Prokurimit të Komunës,
- Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër e Mbrojtje të Mjedisit të Komunës,
- Arkivit



Kryetari i Komunës

Salim Henuzi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –DRAGASH
OPSTINE DRAGAS
MUNICIPALITY OF DRAGAS



Komuna Dragash
 02 Nr. 400-8916
 Dt. 13.06.2016

| | |
|-------------------------------|---|
| PËR/ZA/TO: | Ministria e Diasporës-Prishtinë |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Kryetar i Komunës së Dragashit Salim Jenuzi |
| NGA/OD/FROM: | Komuna Dragash Personi kontaktues : Nexhat Tërshnjaku tel:044225519 |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | <u>Kërkesë për Financimin e Projektit:</u> Dita e Diasporës dhe Organizimi i Panairit me produkte vendore tradicionale |
| DATE: | 13.06.2016 |

Kryetari i Komunës së Dragashit duke u bazua ne Planin e Veprimit për Trashëgimi Kulturore dhe Shpirtërore si dhe Planin Zhvillimor Komunal, organizon **Dita e Diasporës dhe Organizimi i Panairit me produkte vendore tradicionale**, por në mungesë të mjeteve financiare për implementim të këtij projekti:

Kërkojmë nga titulli i lartpërmendur që te na mbështes financiarisht projektin **“Dita e Diasporës dhe Organizimi i Panairit me produkte vendore tradicionale** në Dragash me datë **15 Korrik** .

Qëllimi i organizimit te keti manifestimi është **Ruajtje te trashëgimisë kulturore- promovimi i vlerave te trashëgimisë dhe i produkteve tradicionale-artizanale me qellim te zhvillimit te Turizmit si dhe bashkatdhetarët tanë kanë mundësi te shijojnë këto produkte dhe aktivitete tradicionale.**

Ky projekt është në harmoni të plot me prioritetet e Planin e Veprimit për Trashëgimi Kulturore dhe Shpirtërore, Planit Zhvillimor Komunal (strategjia për turizëm) dhe i cili do të kontribuon drejtpërdrejt në ruajtje te trashëgimisë kulturore, zhvillim të aktivitete rinore ne sport, kulturë dhe rekreacion si dhe ne ruajtje dhe zhvillim te produkteve tradicionale te zonës dhe zhvillim te turizmit .

Manifestimi organizohet për nder te ditës se çlirimit te Komunës se Dragashit me 15.06.2015, por duke e ditur se bashkatdhetarët tanë janë ne pushime vjetore (Komuna e Dragashit ka një përqindje te larte qe jetojnë jashtë vendit) ky manifestim do te mbahet me **15.07.2016** ne Dragash. Siç dihet Muaji Korrik është muaji i pushimeve te diasporës dhe organizimit te ahengjeve familjare te tyre andaj ne këtë event do te mbahet një Program artistik me këngëtar te mirënjohur te estradës sonë.

Planifikohet të marrin pjesë mbi 3000 pjesëmarrës nga Diaspora dhe ata vendor . Fermerët, prodhuesit, përpunuesit me produkte e tyre tradicionale dhe artizanale, do ti ekspozojnë prodhimet e tyre për vizitorët qe do te marrin pjesë ne këto event, pjesëmarrësit do te kenë rastin te furnizohen me produkte tradicionale te komunës se Dragashit- Sharrit.

Ky manifestim, pothuajse është i vetmi ku mund te grumbullohen me mijëra qytetarët te të gjitha moshave, gjinive, komuniteteve nder komunale si dhe nder shtetërore.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –DRAGASH
OPSTINE DRAGAS
MUNICIPALITY OF DRAGAS



Drejtorati për Bujqësi, Pylltari, Inspeksion, Turizëm dhe Zhvillim Rural
Direktoriat za Poljoprivredu, Sumarstvo, Inspekciju, Turizam i Ruralni Razvoj

02 Nr. 400 - 9918

Dt.13.06.2016

Dragash

| | |
|------------------------|---|
| PËR/ZA/TO: | MINISTRINË E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL –MINISTRIT Z.MEMLI KRASNIQI |
| CC: | Kapllan Halimi Sekretar i Përgjithshëm në MBPZHR Prishtinë |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | -Kryetari i Komunës së Dragashit z. Salim Jenuzi |
| NGA/OD/FROM: | -Drejtorati për Bujqësi, Inspeksion, Turizëm dhe Zhvillim Rural Personi kontaktues : Flamur Sylejmani 044 622121 |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | <u>Kërkesë : Për përkrahjen e organizimit të Panairit me produkte tradicionale të Sharrit</u> |
| DATE: | 13.06.2016 |

Komuna e Dragashit, në mungesë të mjeteve financiare për përkrahje të këtij projekti:
Kërkojmë nga MBPZHR që të na mbështes financiarisht projektin **“Organizimi i Panairit me produkte vendore e tradicionale të Sharrit”** me arsyetimin se ky projekt është në harmoni të plot me prioritetet zhvillimore komunale dhe i cili do të kontribuon drejtpërdrejt në zhvillim të qëndrueshëm rural.

Qëllimi i organizimit të këtij panairi është prezantimi i prodhimeve bujqësore-blegtorale dhe artizanale të fermerëve të rajonit tonë në mënyrë që qytetarët të njihen me këto prodhime dhe me cilësinë e tyre, t'u ofrohet mundësia bizneseve lokale-vendore të rrisin pjesëmarrjen e tyre në treg si dhe të bëjë që konsumatorët të njihen me produktet e reja dhe ato ekzistuese.

Ky projekt është në harmoni të plot me prioritetet e Planin e Veprimit për Trashëgimi Kulturor dhe Shpirtëror, Planit Zhvillimor Komunal (strategjia për turizëm) dhe i cili do të kontribuon drejtpërdrejt në ruajtje të trashëgimisë kulturore, kulturë dhe rekreacion si dhe në ruajtje dhe zhvillim ekonomik - zhvillim të produkteve tradicionale të zonës dhe zhvillim të turizmit .

Manifestimi organizohet për nder të ditës së çlirimit të Komunës së Dragashit me 15.06.2015, por për shkak se në këtë datë është Ramazan si dhe duke e ditur se bashkatdhetarët tanë janë në pushime vjetore (Komuna e Dragashit ka një përqindje të lartë që jetojnë jashtë vendit) ky Event- **Panairi me produkte tradicionale** do të mbahet me 15 Korrik -Dita e Diasporës. Vendi ku do të mbahet ky panair është në Qendër të Qytetit – Dragash. Fermerët, prodhuesit, përpunuesit me produkte të tyre tradicionale dhe artizanale, do të ekspozojnë prodhimet e tyre për vizitorët vendore dhe popullatën tonë që vjen nga diaspora për pushimet verore. Pjesëmarrësit- vizitorët do të kenë rastin të furnizohen me produkte tradicionale të komunës së Dragashit- Sharrit.

Buxheti për organizimin – mbajtjen e këtij Panairi me produkte tradicionale është planifikuar **2000 euro**.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna Dragash – Opština Dragaš – Municipality of Dragash

Kryetari i Komunës

02 Nr. 400-10097

Dt: 14. 06. 2016

Dragash

Në bazë të nenit 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

- I. **TË LEJOHEN** mjetet në para të gatshme (KESH) prej nga **45.00 Euro**, në emër të pagesës për punët e kryera në pastrimin e varrezave të Dëshmorëve, siç vijon:
 1. **z.Ramadan Bahtijari**, me nr.të letërnjoftimit – **1000770813**, në shumë prej **45,00 Euro**, dhe
 2. **z.Elvis Bahtijari**, me nr. të letërnjoftimit – **1233617462**, në shumë prej **45,00 Euro**.
- II. Mjetet të lejohen me para të gatshme nga KESHI.
- III. Për implementimin e Vendimit obligohet Drejtoria për Financa, Ekonomi e Zhvillim në bashkëpunim me zyrtarin e KESHIT të Komunës.
- IV. Për procedurat e mëtejme të informohet kryetari i Komunës.

Shtojcë: kopjet e letërnjoftimit.

Vendimi i dërgohet :

- Drejtorisë për Financa, Ekonomi e Zhvillim të Komunës,
- Zyrtarit të KESHIT,
- Paleve, dhe
- Arkivit.

Kryetari i Komunës

Salim Jenuzi





SHKA

“BRESANA”

Komuna e Dragashit

Duke e bazuar ne Planin zhvillimor lokal 2013-2023 te Komunës se Dragashit –ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, duke u bazuar ne nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe ne statutin e Komunës se Dragashit ne nenin 57 kryetari komunës :

MARRVESHJE PËR BASHKFINANCIM

Nr: 400-10313
Dt: 17.06.2016

1. Në mes të :

- **Komunës së Dragashit** , përfaqësuar nga z.Salim Jenuzi- Kryetar i Komunës dhe
- **SHKA “BRESANA” nga Bresana**, përfaqësuar nga z.Fejzal Shaqiri– Kryetar i SHKA-se

2. *Palët e lartshënuara pajtohen me sa vijon:*

Për realizimin e aktiviteteve te përbashkëta dhe pjesëmarrja e SHKA “BRESANA” nga Bresana ne Festivale qe organizohen gjatë vitit 2016 me bashkëfinancim te përbashkët në mes të Komunës se Dragashit dhe SHKA “BRESANA” nga Bresana, ku **qëllimi i keti bashkëpunimi me bashkëfinancim është Ruajtja dhe Promovimi i Trashëgimisë kulturore të komunës se Dragashit brenda Kosovës dhe jashtë saj.**

Vlera e përgjithshme e projektit është **6500 euro** (gjashtë mije euro).

3. **Komuna e Dragashit** do ta mbështes financiarisht projektin me bashkëfinancim **4500 Euro (69 % të vlerës se përgjithshme te projektit)**, Komuna e Dragashit ne zbatimin dhe implementimin e keti projekti do te mbështes edhe me personel .
4. **SHKA “BRESANA” nga BRESANA** do të kontribuojnë në bashkëfinancimin e projektit në vlerë prej **31 %** te vlerës se përgjithshme (**2000 euro**) me mjete vetanake te SHKA-së.

SHKA “BRESANA” nga BRESANA brenda vitit 2016 do te kryej aktivitete - do të merr pjese ne festivale brenda Kosovës dhe jashtë saj si vijon:

- Festivali “Hasi Jehon” Gjonaj – është mbajtur dhe është zënë vendi i parë
- Festivali “Anadrinia Jehon” Dejë - është mbajtur dhe është zënë vendi i parë
- Festivali mesdhetar i Vlorës
- Festivali folklorik – Strugë
- Festivali “Sofra Dibrane” Tetovë
- Festivali i Kaqanikut – Kaqanik
- Si dhe aktivitete përbrenda Komunës

5. *Transferi i mjeteve*

Mjetet financiare të aprovuara nga **Komuna e Dragashit** për këtë projekt do të transferohen në xhirollogarinë **SHKA Bresana** me seli në Bresanë, me numër të regjistrimit **06000179** si dhe me numër të xhirollogarisë **1301001001057110** - banka: BpB ,

6. *Monitorimi*

Monitorimi i projektit-aktiviteteve do të bëhet nga komisioni i autorizuar komunal gjatë implementimit të aktiviteteve.

7. *Raportimi*

SHKA “BRESANA” nga Bresana si bartëse e projektit, pas zbatimit të projektit, do të bëjë një raport detaj mbi shpenzimet e bëra dhe do të raportojë të Komuna e Dragashit .



Kryetari i Komunës së Dragashit



Kryetari i SHKA BRESANA



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/Opština Dragaš/Dragas Municipality

- Kryetari i Komunës

02 Nr. *400 - 10526/16*

Dt.22. 06. 2016

D r a g a s h

Në bazë të nenit 13 e 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

- I. **THEMELOHET** Komisioni (Organi) për Pranim Teknik në realizimin e punimeve në projektin: **"Kubëzimi i rrugëve në fsh.Zaplluxhe "** - Komuna Dragash, në përbërje:
 1. **Xhevat Isufi,**
 2. **Vetim Hasani, dhe**
 3. **Džulbehar Taipi**
- II. Për implementimin e këtij Vendimi **OBLIGOHET** Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastër e Mbrojtje të Mjedisit të Komunës.
- III. Detyrë e anëtarëve të Komisionit është hartimi i Raportit lidhur më këtë dhe njoftimi i organeve të lartçekura.
- IV. Për hapat e më tejme të njoftohet kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarve të Komisionit...
- Zyrës për Prokurimit të Komunës.
- Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër e Mbrojtje të Mjedisit të Komunës, dhe
- Arkivit.

Kryetari i Komunës
Salim Jenuzi





Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/Opština Dragaš/Dragas Municipality

- Kryetari i Komunës

02 Nr. 400-10892/16

Dt. 28. 06. 2016

D r a g a s h

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe nenit 57 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, bie këtë:

V E N D I M

- I. **THEMELOHET** Komisioni (Organi) për Pranim të projektit: **“Printimi i Broshurës Turistike” - Komuna Dragash**, projekt i Komisionit Evropian, në përbërje:
 1. Nexhat Tërshnjaku,
 2. Burim Aliu, dhe
 3. Hazer Shyqëriu
- II. Për implementimin e këtij Vendimi **OBLIGOHET** Zyra e Prokurimit në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi, Turizëm, Zhvillim Rural të Komunës.
- III. Detyrë e anëtarëve të Komisionit është hartimi i Raportit lidhur më këtë dhe njoftimi i organeve të lartëcekura.
- IV. Për hapat e ndërmarra të njoftohet kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit...
- Zyrës së Prokurimit të Komunës,
- Drejtorisë për Turizëm të Komunës, dhe
- Arkivit.



Kryetari i Komunës

Edin Jenuzi